



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
30 KORRIK 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
30. JULA 2008. GODINE

Korrik – Juli
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L08 për miratimi e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.
2. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e datës së mbajtjes së regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

D n e v n i r e d

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona br.03/L08 o usvajanju Budžeta Kosova i o autorizovanim rashodima za period od 1. januara do 31. decembra 2008.
2. Razmatranje Predloga odluke Vlade Republike Kosova o određivanju datuma održavanja popisa stanovništva, domaćinstava i stanova.

A g e n d a

1. Second reading of the Draft law on amendment and supplementation of the law nr.03/L08 in approving the Kosovo Budget and authorized expenditures for period from 1 January 31 until December 2008.
2. Review of the Proposal-decision made by Government of Republic of Kosovo in arranging the date for registration of the population, family and dwelling economy.

Seancën plenare e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 82 deputetë dhe janë plotësuar kushtet për të filluar me punë.

Në materialin, të cilin ju e keni marrë, kemi me dy pika të rendit të ditës.

Mirëpo, pika e dytë e rendit të ditës, për shkaqe teknike dhe të mungesës së ministrit - shtyhet për një seancë tjetër.

Prandaj, për sot e kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L08 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008**

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë në seancën e djeshme, më 29 korrik 2008.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit për vitin 2008 dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raporti i Komisionit funksional iu është shpërndarë deputetëve.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme, ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Fjalën e ka Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë do të jem shumë i shkurtër sepse të gjithë i keni rekomandimet e Komisionit. Komisioni ka bërë një punë intensive bashkërisht me propozuesin e ndryshimit të Ligjit për buxhetin dhe ka sjellë para jush këto rekomandime, të cilat i keni përpara me amendamentet e propozuara.

Prandaj, meqë këto i keni para veti, do të thosha, vetëm nëse duhet ndonjë sqarim eventual, atëherë jemi këtu si Komision për ta bërë atë sqarim. Këtu është edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe mund të sqarojmë për çështje të caktuara. Prandaj, edhe do të kisha propozuar që të vazhdohet me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni për ndryshimin e Ligjit të buxhetit.

KRYETARI: Faleminderit!

Do të vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për të votuar. Votojmë tash:

Amendamenti 1.

Faleminderit! Konstatohet se me 59 vota “për”, 13 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 13 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 9 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

T’ju bëj me dije se në sallë tani janë 75 deputetë.

Konstatohet se me 60 vota “për”, 7 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 7 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, 8 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 10 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 9 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti i fundit i 9.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 8 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9 dhe i fundit.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Konstatohet se me 61 votë “për”, 11 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L08 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.

Të nderuar deputetë,

Me këtë votim ne po përmbylлим sesionin pranveror dhe ndjej për obligim që t'ju falënderoj për angazhimin dhe punën e bërë të përbashkët dhe konstruktive që e kemi pasur gjatë kësaj kohe.

Ju falënderoj edhe për angazhimet e shumta që i kemi pasur së bashku. Mendoj që kemi kryer punë të mirë dhe të rëndësishme.

Tani, shfrytëzoj rastin t'ju dëshiroj pushim të mirë dhe të këndshëm. Faleminderit!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve